



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Blv. "Gjergj Fishta", Tiranë, adresë web: www.gjykatatirana.gov.al

Datë 22.04.2022



Sot, më datë 22.04.2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u lançua sistemi i ri dhe inovativ online, i cili synon të mbledhë komentet e avokatëve, prokurorëve, ekspertëve, dëshmitarëve dhe palëve në një çështje gjyqësore, si dhe përdoruesve të shërbimeve administrative, me qëllim përmirësimin e shërbimit të drejtësisë.

Sistemi iu prezantua sot përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë, partnerëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe mediave, në një aktivitet publik të organizuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Në fjalën e saj, znj. Llagami theksoi rëndësinë e sistemit të ri online për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të drejtësisë dhe për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta në funksionimin e gjykatave nga këndvështrimi i përdoruesve. *“Sot ne kemi një instrument që e administrojnë Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili na jep mundësi të masim cilësinë e shërbimeve të ndryshme të gjykatave. Kjo përbën një risi për t’u përgëzuar, prandaj dëshiroj të falenderoj Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës për mbështetjen e dhënë”*, u shpreh Llagami.

Z. Flamur Kapllani, Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fjalën e tij përshëndetëse u fokusua në rëndësinë e këtij sistemi vlerësimi për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. *“Ky pyetësor do na shërbejë për të identifikuar ato mangësi që gjykata nuk i sheh, dhe*

të mund t'i adresojmë këto mangësi duke përmirësuar shërbimet tona dhe qytetarët ta perceptojnë që drejtësia vërtet po jepet.”, theksoi Kapllani.

Znj. Jutta Gützkoë, Shefja e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, në fjalën e saj njohu progresin në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit publik të drejtësisë që u ofrohet qytetarëve shqiptarë, në përputhje me vlerat evropiane si pjesë e rëndësishme e reformës së vazhdueshme në drejtësi. *“Në këtë fazë të reformës në drejtësi, reagimet e përdoruesve të gjykatave, identifikimi i nevojave të tyre dhe vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara janë element kyç për të mbështetur gjykatat kombëtare për të ofruar shërbime të përmirësuara të drejtësisë për qytetarët shqiptarë”*.

Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, ritheksoi mbështetjen e Bashkimit Evropian në forcimin e cilësisë së sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Ai përgëzoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për mundësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor si dhe Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për këtë instrument, z. Perr, falenderoi gjithashtu, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për mbështetjen në pilotimin e këtij projekti për herë të parë në Shqipëri. *“Përmes këtij pyetësoi online dhe rezultateve që ai ofron ne synojmë, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë si dhe përmirësimin e imazhit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri”*, përfundoi Perr.

Platforma online do të pilotohet në gjykatat e rretheve të Tiranës dhe Vlorës për t'u shtrirë më tej në gjykatat e mbetura me finalizimin e hartës së re gjyqësore. Përdoruesit e gjykatave mund të aksesojnë dhe plotësojnë anketën duke skanuar kodin QR nga tabelat e vendosura në gjykatë ose nëpërmjet faqeve përkatëse të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Matja e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës në lidhje me aspektet kyçe të shërbimit të drejtësisë synon jo vetëm të rrisë përgjegjshmërinë dhe reagimin e administratës të gjykatës, por edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

I pari i këtij lloji në Shqipëri, sistemi është një iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor i zhvilluar me mbështetjen e projektit të BE/KIE për Forcimin e Efikasitetit dhe Cilësisë të Drejtësisë në Shqipëri, pjesë e nismës së përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019- 2022”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë



KOMUNIKIM PËR MEDIAT

Përmirësimi i performancës së gjykatave në Shqipëri, përmes anketave të kënaqësisë së përdoruesve

22 Prill 2022, Tiranë – Përdoruesit e gjykatave tani në Shqipëri do të kenë mundësinë të vlerësojnë cilësinë dhe efikasitetin e performancës së gjykatave bazuar në përvojën e tyre individuale. Sistemi i ri dhe inovativ online, i lançuar sot në Gjykatën e Rrethit Tiranë, do të synojë të mbledhë komentet e avokatëve, prokurorëve, ekspertëve, dëshmitarëve dhe palëve në një çështje gjyqësore, si dhe përdoruesve të shërbimeve administrative, me qëllim përmirësimin e shërbimit të drejtësisë.

Sistemi iu prezantua sot përfaqësuesve kryesorë nga institucionet e drejtësisë, partnerët ndërkombëtarë, shoqëria civile dhe media në një aktivitet publik të organizuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Naureda Llagami - Kryetare e Këshillit të Lartë të Gjyqësor, theksoi rëndësinë e sistemit të ri online për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të drejtësisë dhe për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta në funksionimin e gjykatave nga këndvështrimi i përdoruesve. *“Sot ne kemi një instrument që e administron Këshilli i Lartë Gjyqësor, i pari në rajon por edhe vende të tjera të BE-së nuk e kanë, që na jep mundësi të masim cilësinë e shërbimeve të ndryshme të gjykatave. Kjo përbën një risi për t’u përgëzuar, dhe dua të falenderoj Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës për mbështetjen e tyre”,* u shpreh Llagami.

Flamur Kapllani - Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Tiranë në fjalën e tij përshëndetëse u fokusua në rëndësinë e këtij sistemi vlerësimi për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. *“Ky pyetësor do na shërbejë për të identifikuar ato mangësi që gjykata nuk i sheh, dhe të mund t’i*

adresojmë këto mangësi duke përmirësuar shërbimet tona dhe qytetarët e publiku ta perceptojnë që drejtësia vërtet po jepet.”, theksoi Kapllani

Jutta Gützkow - Shefja e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë në fjalën e saj njohu progresin në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit publik të drejtësisë që u ofrohet qytetarëve shqiptarë, në përputhje me vlerat evropiane si pjesë e rëndësishme e reformës së vazhdueshme në drejtësi. *“Në këtë fazë të reformës në drejtësi, reagimet e përdoruesve të gjykatave, identifikimi i nevojave të tyre dhe vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara janë element kyç për të mbështetur gjykatat kombëtare për të ofruar shërbime të përmirësuara të drejtësisë për qytetarët shqiptarë”, u shpreh Gützkow.*

Hubert Perr – Shef i Bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri ritheksoi mbështetjen e Bashkimit Evropian në forcimin e cilësisë së sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Ai përgëzoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për mundësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor si dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit për këtë instrument, si dhe falenderoi Gjykatën e Rrethit Tiranë për mbështetjen në pilotimin e këtij projekti për herë të parë në Shqipëri. *“Përmes këtij pyetësi online dhe rezultateve që ai ofron rrisim transparencën, përgjegjshmërinë si dhe përmirësojmë imazhin e sektorit të drejtësisë në Shqipëri”, përfundoi Perr.*

Platforma online do të pilotohet në gjykatat e rretheve të Tiranës dhe Vlorës për t'u shtrirë më tej në gjykatat e mbetura me finalizimin e hartës së re gjyqësore. Përdoruesit e gjykatave mund të aksesojnë dhe plotësojnë anketën duke skanuar kodin QR nga tabelat e vendosura në gjykatë ose nëpërmjet faqeve përkatëse të internetit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Matja e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës në lidhje me aspektet kyçe të shërbimit të drejtësisë synon jo vetëm të rrisë përgjegjshmërinë dhe reagimin e administratës të gjykatës, por edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

I pari i këtij lloji në Shqipëri, sistemi është një iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor i zhvilluar me mbështetjen e projektit të BE/KiE për Forcimin e Efikasitetit dhe Cilësisë të Drejtësisë në Shqipëri,

pjesë e nismës së përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019- 2022”.

Informacion:

Donald XHELILI – Kancelar i Gjykatës së Tiranës (email/phone)

[Besnik BAKA](#) – Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë – Tel: 00355692178430

PRESS RELEASE

Improving court's performance through user satisfaction surveys: new system launched in Tirana today

22 April 2022, Tirana – Court users in Albania will now have the possibility to evaluate the quality and efficiency of Courts' performance, based on their individual experiences. The innovative online system launched today at Tirana District Court will collect the feedback of lawyers, prosecutors, experts, witnesses, and parties in court cases, as well as users of administrative services with the view to improve the justice service.

The court user satisfaction surveys were presented today to key representatives from the justice institutions, international partner organisations, civil society and media in a public event organised by the High Judicial Council and Tirana District Court, with the support of the European Union and the Council of Europe.

Naureda Llagami, Chair of the High Judicial Council, stressed the importance of the new online system in assessing the quality of justice-related services and in identifying strengths and weaknesses in the courts' functioning from the users' perspective. *"Today we have an instrument administered by the High Judicial Council, the first in the region but other EU countries do not have it, which allows us to measure the quality of various court services. This is a novelty to be commended, and I want to thank the European Union and the Council of Europe for their support,"* said Llagami in her remarks.

Flamur Kapllani - Deputy Chair of the Tirana District Court focused in his address on the importance of this assessment tool to improve the justice system. *"This questionnaire will serve to identify those shortcomings that the court does not see, and to be able to address these shortcomings by improving our services and the public and the public to perceive that justice is really being done."*, emphasised Kapllani.

Jutta Gützkow, Head of the Council of Europe Office in Tirana, recognised the progress in improving the efficiency and quality of the public service of justice delivered to the Albanian citizens in accordance with European values as important part of the ongoing reform of the judiciary. *"At this stage of the reform in the judiciary, the feedback of court users, e. of lawyers, prosecutors, experts, witnesses, and parties in a court case, the identification of their needs and the evaluation of the quality of the services offered by the courts will support the courts in further improving the justice services to Albanian citizens"*, concluded Gützkow

Hubert Perr, Head of Co-operation at European Union Delegation in Albania, reiterated the EU support towards the strengthening the quality of the justice system in Albania. He congratulated the High Judicial Council for providing the legal framework as well as the IT and digital tools to establish this online mechanism. Perr also thanked Tirana District Court for piloting this project for the first time in Albania. *"Through this online questionnaire and the results it offers, we aim to increase transparency and accountability of the judiciary in Albania"*, stressed Perr.

The online platform will be piloted in the district courts of Tirana and Vlora, and is to be further rolled out in the remaining courts after the finalisation of the new judicial map. Court users can access and fill in the survey by scanning the QR code from the billboards placed at the court premises or through the websites of High Judicial Council and the Tirana District Court.

The measurement of court users' satisfaction will contribute to increasing the accountability and responsiveness of the court's management and ultimately increase public confidence in the justice system.

The introduction of court user satisfaction surveys, the first of its kind in Albania, is an initiative of the High Judicial Council developed with the support of the EU and Council of Europe action on "Strengthening the Quality and Efficiency of Justice in Albania". It is part of the European Union and Council of Europe joint programme "Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey 2019-2022".

For more information:

Donald XHELILI - Chancellor of Tirana District Court (email/phone)

[Besnik Baka](#) – Council of Europe Office in Tirana – Tel: 00355692178430